



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KUVENDI**  
**KOMISIONI I POSAÇËM PARLAMENTAR**  
**“PËR THELLIMIN E REFORMAVE PËR MIRËQEVERISJEN, ANTIKORRUPSIONIN**  
**DHE SUNDIMIN E LIGJIT PËR SHQIPËRINË 2030 NË BASHKIMIN EUROPIAN”**

**PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE**  
**E**  
**PLANIT KOMBËTAR TË VEPRIMIT**

## Përmbledhje shpjeguese e Planit Kombëtar të Veprimit

Shqipëria është në një fazë jetike në procesin e anëtarësimit në Bashkimin Europian, prioriteti më i rëndësishëm dhe i vetëm për vendin tonë. Sfida e hapjes dhe mbylljes së pozicioneve negociuese për 6 grup-kapitujt, sipas kushteve dhe kriterëve të vendosura nga BE-ja deri në vitin 2027, është kuadri udhëheqës i të gjitha reformave që vendi duhet të ndërmarrë.

Në përmbushje të kësaj sfide, me ambicien e përcaktuar qartë për anëtarësimin në BE në 2030-n, nevojitet një angazhim më i madh nga të gjithë aktorët në përmbushjen e kriterëve të negociatave, veçanërisht të Grup-kapitullit I “Themeloret”. Kuvendi ka përgjegjësinë dhe mundësinë për të luajtur një rol më proaktiv dhe udhëheqës në këtë proces jetik për të ardhmen e vendit, në përmbushjen e angazhimeve të tij në kuadër të këtij procesi, por dhe hapësirën kushtetuese për të marrë një rol udhëheqës në bashkërendimin dhe koordinimin e të gjitha institucioneve të shtetit në funksion të këtij objekti madhor.

Gjithashtu, Shqipëria, me miratimin e reformës në drejtësi dhe impaktit që ajo po jep, është në një moment pozitiv për thellimin e mëtejshëm të reformave edhe në fusha të tjera të rëndësishme për të garantuar të njëjtat standarde, në funksion të konsolidimit të mëtejshëm të shtetit të së drejtës. Në këtë kontekst, një analizë e kujdesshme e proceseve të deritanishme ka çuar në përfundimin se vendi ka nevojë për një cikël tjetër reformimi duke konsideruar prioritare sfidat e: i) mirëqeverisjes, ii) antikorrupsionit dhe iii) sundimit të ligjit, si sfida kyç për forcimin e demokracisë dhe shtetit të së drejtës. Kjo është rruga e vetme dhe e qëndrueshme për të hyrë me meritë në BE, për t’u bërë me dinjitet pjesë e familjes europiane, me ambicien tonë: Shqipëria 2030 në BE.

Kuvendi, me rezolutën e miratuar më 27 maj 2024 “Për thellimin e reformave për mirëqeverisjen, antikorrupsionin dhe sundimin e ligjit për Shqipërinë 2030 në BE”, si dhe me vendimin nr. 50 datë 30.5.2024 për ngritjen e Komisionit të Posaçëm Parlamentar për të drejtuar këtë proces strategjik dhe reformues, shprehu vizionin, përgjegjësinë dhe ndërmori angazhimin për thellimin e këtij cikli reformash në funksion të objektivit strategjik “Shqipëria 2030 në BE”.

Kuvendi, bazuar në kompetencat e tij kushtetuese dhe përvojën e krijuar, synoi të marrë një rol udhëheqës në drejtim të thellimit të reformave për mirëqeverisjen, parandalimin dhe luftën ndaj korrupsionit dhe sundimin e ligjit përmes hartimit të një Dokumenti Analitik dhe Plani Kombëtar të Veprimit (PKV) për të adresuar përballimin e këtyre sfidave madhore, në shërbim të qytetarëve dhe të ardhmes së vendit, si kontribut i drejtpërdrejtë në përshpejtimin e procesit të anëtarësimit të Shqipërisë në BE.

Komisioni i Posaçëm Parlamentar nëpërmjet PKV-së, si dokumenti themelor reformues në këto 3 shtylla, dhe masave të parashikuara synon:

- Adresimin e masave të nevojshme për reflektime politike, institucionale e ligjore në 3 sfidat, që impaktojnë drejtpërdrejt shoqërinë në procesin e anëtarësimit në BE, për përmirësimin dhe konsolidimin e praktikave të mirëqeverisjes në të gjitha nivelet, për parandalimin dhe thellimin e luftës kundër korrupsionit, si dhe forcimin e mëtejshëm të sundimit të ligjit.

- Reformimin e Kuvendit dhe rolit të deputetit në reflektim edhe të rekomandimeve të BE-së për rritjen e përgjegjshmërisë, transparencës, llogaridhënies dhe gjithëpërfshirjes në përmbushje të nevojës për të pasur një parlament tërësisht funksional për ushtrimin më eficient të përgjegjësiave kushtetuese dhe përmirësimin cilësisht të rolit ligjvënës, monitorues, mbikëqyrës e koordinues të Kuvendit.
- Rritjen e rolit udhëheqës të Kuvendit në procesin e anëtarësimit të Shqipërisë në BE përmes përmbushjes së përgjegjësiave të drejtpërdrejta për përshpejtimin e këtij procesi, si dhe duke luajtur një rol më proaktiv për një koordinim e ndërveprim më të mirë ndërmjet tri pushteteve, në respektim të parimit të kontrollit dhe balancës (*check & balance*), në funksion të përgjegjësiave të përbashkëta në procesin e anëtarësimit të vendit, me qëllim për të garantuar përmbushjen e kritereve të negociatave për Grup-kapitullin I “Themeloret” në këto fusha, sipas afateve dhe cilësisë së kërkuar nga BE-ja.

Vendimi nr. 50 i Kuvendit ka përcaktuar qartë qëllimet dhe objektin e punës së Komisionit, si edhe qasjen dhe metodologjinë e tij për të garantuar një proces të mbështetur në frymën kushtetuese dhe normat e parashikuara nga Rregullorja e Kuvendit. Komisioni i Posaçëm Parlamentar, përmes një procesi të jashtëzakonshëm impenjimi, në harkun e një viti shumë të ngarkuar pune, me një kalendar të ngjeshur aktiviteteve, arriti të realizojë një proces tejet gjithëpërfshirës, transparent, profesional dhe në standardet më të mira ndërkombëtare. Ai mundi të bashkojë në këtë proces të gjithë faktorët politikë e shoqërorë, aktorët institucionalë, legjislativin dhe ekzekutivin, institucionet kushtetuese dhe ato të pavarura të krijuara me ligj, shoqërinë civile, median, botën akademike, ekspertizën më të mirë vendase të asistuar edhe nga një ekspertizë e pasur ndërkombëtare në këtë fushë, si dhe asistencën e monitorimin e përfaqësuesve dhe ekspertizës së partnerëve ndërkombëtarë.

Plani Kombëtar u hartua nga Grupi i Ekspertëve të Nivelit të Lartë (GENL), vendas e ndërkombëtarë, me mbështetjen e Sekretariatit Teknik (ST) të Kuvendit dhe në konsultim të gjerë me qytetarët, institucionet shtetërore, grupet e interesit, shoqërinë civile dhe organizatat ndërkombëtare.

Procesi i përgatitjes dhe miratimit të Planit të Veprimit ka kaluar në disa faza të rëndësishme: i) vlerësimi i dokumentit analitik dhe identifikimi i masave prioritare; ii) miratimi i formatit të Planit Kombëtar të Veprimit; iii) prezantimi dhe miratimi në parim i Planit Kombëtar të Veprimit; iv) konsultimi publik i PKV-së; v) miratimi i PKV-së duke u përballur me disa sfida të rëndësishme në hartimin e tij.

Angazhimi i Kuvendit nëpërmjet këtij Planit Kombëtar të Veprimit është i ndarë në masa sipas shtyllave kryesore dhe përfshin 56 fusha tematike dhe 245 masa specifike (nga të cilat 71 masa ligjore dhe 174 masa institucionale). Të ndara sipas tri shtyllave kryesore, totali i masave ka shpërndarjen si më poshtë:

- Mirëqeverisja: 25 fusha tematike; 68 masa (16 nisma ligjore; 52 masa institucionale).
- Antikorrupsioni: 8 fusha tematike; 95 masa specifike (38 nisma ligjore; 57 masa institucionale).
- Sundimi i ligjit: 23 fusha tematike; 82 masa (17 nisma ligjore; 65 masa institucionale).

Plani Kombëtar i Veprimit, si dokumenti kryesor i KPP-së, ka si qëllim të ofrojë një kuadër strategjik të qartë dhe të zbatueshëm të masave reformuese ligjore dhe institucionale, duke reflektuar gjetjet dhe rekomandimet kryesore të Dokumentit Analitik në tri shtyllat kryesore për mirëqeverisjen, antikorrupsionin dhe sundimin e ligjit.

PKV-ja është konceptuar si një dokument angazhimesh, i cili parashikon një sërë masash konkrete, legjislative dhe institucionale, të orientuara drejt përmbushjes së përgjegjësiave dhe angazhimeve duke vendosur në qendër rolin dhe përgjegjësinë e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë për këto reforma, në kuadër të procesit të negociatave për Grup-kapitullin I “Themeloret”, për anëtarësimin e vendit në Bashkimin Europian.

Plani synon jo vetëm të adresojë sfidat strukturore dhe institucionale të konstatuara, por edhe të nxisë një transformim të thellë të kulturës politike dhe administrative, bazuar në parimet e përgjegjshmërisë, meritokracisë, profesionalizmit dhe efikasitetit.

PKV-ja është një dokument konkret dhe i matshëm, me masa legjislative dhe institucionale, me afate të mirëpërcaktuara dhe të linjëzuara me kërkesat e BE-së, në kuadër të procesit të negociatave, si dhe të angazhimeve të shprehura në dokumentet përkatëse të qeverisë shqiptare. Masat e propozuara në këtë plan mbështeten në një kombinim të analizës ligjore dhe kërkimore, mbi dokumente, raporte dhe studime të disponueshme në secilën prej shtyllave dhe prioritarizimit të gjetjeve të kësaj analize në përputhje me angazhimet e Shqipërisë në procesin e negociatave (piketat hapëse, të ndërmjetme, si dhe piketat mbyllëse), si dhe rritjes së angazhimit dhe ngritjes së kapaciteteve të Kuvendit për të ndjekur dhe monitoruar procesin e negociatave me BE-në.

Plani Kombëtar i Veprimit është i linjëzuar tërësisht me angazhimet e ndërmarra në kuadrin e negociatave me BE-në dhe ka shmangur çdolloj dublimi apo mbivendosjeje me masat ekzistuese të dokumenteve të miratuara në këtë fushë. Nisur nga roli dhe përgjegjësia e qeverisë shqiptare për udhëheqjen e negociatave me BE-në, KPP-ja ka bërë pjesë të grupeve të tij të punës përfaqësuesit dhe ekspertët e disa ministrive dhe institucioneve, me fokus çështjet e integritetit, antikorrupsionin e qeverisjes vendore dhe veçanërisht, grupin e negociatorëve pranë Kryenegociatores për procesin e integritetit, me qëllim që masat e PKV-së të jenë të linjëzuara me të gjitha masat dhe afatet e dakordësuara me BE-në. GENL-ja, gjatë hartimit të PKV-së, ka analizuar dhe krahasuar çdo dokument strategjik që lidhej me fushën, masat në 3 udhërrëfyesit e miratuar nga qeveria shqiptare për Grup-kapitullin I, si dhe piketat e ndërmjetme në pozicionin e përbashkët të BE-së, me qëllim për të garantuar që masat, afatet dhe institucionet të jenë të përputhura mbi bazën e angazhimeve që shteti shqiptar ka marrë në këtë proces, si dhe përmirësimin e rolit monitorues, mbikëqyrës e koordinues të Kuvendit në zbatimin e këtyre angazhimeve institucionale.

Gjatë hartimit dhe diskutimit të dokumenteve kryesore të tri shtyllave janë përfshirë edhe ekspertë të huaj me përvojë ndërkombëtare në këto fusha, si dhe ekspertë të programeve të asistencës së institucioneve dhe organizatave ndërkombëtare. Ekspertiza e tyre ka pasur në fokus edhe përputhshmërinë e gjetjeve të analizës dhe rekomandimeve të saj, masave të parashikuara në PKV me rekomandimet e dokumenteve të dakordësuara në kontekstin e negociatave të

pranimit, si dhe reflektimin në këto dokumente të standardeve dhe praktikave më të mira europiane.

PKV-ja përmban indikatorët për ta bërë të matshëm zbatimin, si dhe institucionet përgjegjëse për zbatim, duke vendosur theksin te roli dhe përgjegjësitë kushtetuese dhe ligjore të Kuvendit.

Për të garantuar realizimin e suksesshëm të masave të parashikuara në PKV është ndërtuar një strukturë e qartë dhe funksionale monitorimi, e cila kombinon mbikëqyrjen institucionale, transparencën publike dhe përfshirjen e të gjitha palëve të interesit. Vlerësimi i përparimit të progresit do të kryhet në mënyrë të vazhdueshme, përmes raportimeve periodike çdo tre muaj dhe analizave përmbledhëse vjetore, të cilat do të pasqyrojnë nivelin e realizimit të objektivave, në bazë të indikatorëve të qartë dhe të matshëm. Në këtë proces do të luajnë rol të rëndësishëm edhe përfaqësuesit e shoqërisë civile dhe partnerët ndërkombëtarë, të cilët do të kontribuojnë në monitorimin e jashtëm, duke ofruar një perspektivë të pavarur dhe gjithëpërfshirëse. Gjithashtu, parashikohet funksionimi i një platforme digjitale të dedikuar, që do të shërbejë si kanal komunikimi dhe transparence për publikun, duke mundësuar akses të hapur në informacion mbi ecurinë e zbatimit dhe rezultatet e arritura.

Ky Plan përbën një instrument dinamik parlamentar për thellimin e reformave, i cili kërkon bashkëpunim të ngushtë ndërinstitutional, angazhim politik të vazhdueshëm dhe përfshirje aktive të publikut dhe partnerëve ndërkombëtarë. Zbatimi i këtij plani do të jetë një vlerë e shtuar në rritjen e përgjegjësisë të të gjitha institucioneve në përmbushjen e kriterëve të kërkuara në kuadër të anëtarësimit të Shqipërisë në BE.

Plani Kombëtar i Veprimit, bashkëngjitur, është një dokument parlamentar me vlera të shumanshme, efekti shumë pozitiv i të cilave do të përcaktohet nga shkalla e angazhimit për zbatimin e tij nga Kuvendi dhe strukturat e tij në legjislaturën e ardhshme 2025 – 2029, në funksion të ambicies sonë legjitime – Shqipëria 2030 në BE.